

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: *BLERJE KANCELARI*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 30192111-2, 30192124-6, 30192127-7, 22816300-6, 22852000-7, 30199230-1, 30197642-8, 30234300-1, 30234400-2, 30237132-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.000.000 (dy milion) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Rrogozhinë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimiit/Kualifikimit.

2.1.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022-2023-2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektivit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

2.2.2 Vetëdeklarimin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës së vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në bazë të pikës 2, të nenit 76, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe neni 43, pika 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik

Operatori ekonomikë duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të provuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionet e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar në sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati I përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku të shënohen gatat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuar.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar në sektorin privat operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularine e vetëdeklarimit se duhet të ketë në pronësi ose me qira mjetet e domosdoshme për realizimin e kontratës (transportin e materialeve), si më poshtë:

a) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqiten:

1. leje qaarkullimi e vlefshme;
2. certifikatën e kontrollit teknik të vlefshme;
3. policë sigurimi e vlefshme;
4. mjeti të shoqërohet me fotografi të dukshme;
5. certifikatë për leje transporti të lëshuar nga Bashkia.

b) Për mjetet me qira duhet të paraqiten:

1. kontrata noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj;
2. certifikatën e kontrollit teknik të vlefshme;
3. policë sigurimi e vlefshme;
4. mjeti të shoqërohet me fotografi të dukshme;
5. certifikatë për leje transporti të lëshuar nga Bashkia.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteri vlerësohet si i nevojshëm për ekzekutimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme në lidhje me mallrat objekt prokurimi të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave:

- Certifikatë ; Sistemi menaxhimit të Cilësisë (**ISO 9001**)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79, "Standartet e sigrimit të cilësisë" të të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Për shkak të natyrës së vecantë, vendodhjes dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmushin kontratën me standartet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë është standart për çdo subjekt juridik apo privat dhe ka qëllim në arritjen e suksesit. Referuar nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standartet për menaxhimin e cilësisë, përfshirë edhe edhe standartet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 9001:2015 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë: Është një standart ndërkombëtarë I dedikuar për sistemet e menaxhimit të cilësisë, I cili përshkruan një kornizë në përmirësimin e cilësisë për çdo organizatë që kërkon të ofrojë produkte dhe shërbime conform kërkesave dhe pritshmërisë së klientëve/palëve të interesuara në mënyrë më efektive të mundshme. Ndër të tjera ky standart harmonizohet me objektivat dhe planet e RSU NR.1 , në rritjen gjithënjë e më shumë të cilësisë në punët e përditshme dhe përafrimin me procedurat e ngajshme me vendet e tjera të zhvilluara.

2.3.3 Operatori ekonomikë ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se merr përsipër furnizimin e mallrave pranë Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 8 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Ky kriter vlerësohet i nevojshëm për ekzekutimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

NJËSIA E PROKURIMIT